

Lushnje, 21.06.2023

STATUT

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"AGL Building Trade and Consulting" SH.P.K.

Ne Baze te Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008, "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", me vullnetin tone te plote dhe te lire, te shprehur ne nënshkrimin e ketij Statuti,

1. **Z. Artur Shapka**, emri i babait **Vasil Shapka**, lindur ne Durrës me 28.09.1972 dhe banuese ne Lagja 17, Pallati 774, Durrës, me Pasaporte nr. BA8286436, Shtetas Shqiptar, madhore me zotësi te plote juridike për te vepruar, lindur ne Durrës me 28.09.1972 dhe banuese ne Lagja 17, Pallati 774, Durrës, me Pasaporte nr. BA8286436, Shtetas Shqiptar, madhore me zotësi te plote juridike për te vepruar

2. **Z. Giovanni Ferraro**, emri i babait **Giuseppe Ferraro**, lindur ne Pompei, Napoli (Itali) me 08.02.1978 dhe banues ne Rr. Annunziatella, nr.135, Boscotrecase (Napoli – Itali), cap. 80042. Pasaporte nr. YC0737033, Shtetas Italian, madhor me zotësi te plote juridike për te vepruar,

hartojne ketë statut si me poshtë vijon:

EMERTIMI I SHOQERISE, SELIA, KOHEZGJATJA, OBJEKTI

NENI 1

EMERTIMI I SHOQERISE

Emri i shoqërisë është "AGL Building Trade and Consulting" Sh.p.k.


NENI 2

SELIA

Selia e shoqërisë "Zona Kadastrale 8571, nr. Pasurie 2-74-N4, Lagja Clirimi, Lushnje".

NENI 3

KOHEZGJATJA



Kohëzgjatja e shoqërisë, si e parashikuar ne Aktin e Themelimit PA AFAT. Shoqëria e fiton personalitetin e vet juridik nga momenti i regjistrimit ne Qendrën Kombëtare te Biznesit (QKB).

NENI 4

OBJEKTI


Objekti i veprimtarisë se shoqërisë "AGL Building Trade and Consulting" SH.P.K. është:

Veprimtari në fushën e bujqësisë, blegtorisë, pemtarisë dhe prodhimeve të detit. Tregtimi, përpunimi, eksporti, importi i prodhimeve bujqësore, blegtorale të papërpunuara dhe të papërpunuara dhe imputeve dhe makinerive bujqësore të të gjitha llojeve. Veprimtari në sektorin e agroindustrialisë. Përpunimi paraprak dhe përfundimtar i produkteve të ndryshme bujqësore, blegtorale dhe frutore, tregti me shumicë dhe pakicë të pajisjeve teknologjike, makinerive, laboreve të cilësisë dhe pajisjeve të tjera, që drejtpërdrejtë ose tërthorazi lidhen me sektorin e agroindustrialisë. Veprimtari tregtimi me shumice dhe pakice te veshmbathjeve dhe artikujve sportive. Veprimtari në fushën e transportit kombëtar dhe ndërkombëtar të mallrave. Veprimtari në fushën e mjedisit dhe agroturizmit. Veprimtari në fushën e ndërtimit, montimit të impianteve të përpunimit të prodhimeve bujqësore, blegtorale, prodhimeve të detit, etj. Veprimtari në fushën e marketingut të prodhimeve agroindustriale, bujqësore, blegtorale, mjedisore, ndërtimit, makinerive, pajisjeve, etj, të lidhura drejtpërdrejtë ose tërthorazi me agroindustrinë, mjedisin, transportin, etj. Veprimtari financiare në fushën e mbështetjes së bashkëpunimit të fermerëve, kooperativave bujqësore dhe organizmave të tjera vendit dhe ndërkombëtare të lidhura drejtpërdrejtë ose tërthorazi me sektorët e agroindustrialisë, agroturizmit, mjedisit, peshkimit, etj. Veprimtari në sektorin e arsimit profesional për sektorët e lidhur me objektin e veprimtarisë së shoqërisë. Veprimtari në fushën e çertifikimit, akreditimit, standarteve në sektorin e agroindustrialisë, bujqësisë, blegtorisë, pemtarisë, peshkimit, etj. Shoqëria mund të kryejë çdo transaksion në lidhje me pasuritë e luajtshme apo të paluajtshme si dhe çdo aktivitet tregtar, financiar, qeradhënieje apo hipoketimi, të cilat mund të konsiderohen si të dobishme apo të nevojshme për arritjen e objektit të Shoqërisë. Të blejë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë interesa në shoqëri të tjera me objekt të ngjashëm me atë të Shoqërisë, në Shqipëri apo jashtë saj, dhe të kryejë çdo aktivitet tjetër që mund të konsiderohet i dobishëm apo i nevojshëm në mënyrë arritjen e objektit të Shoqërisë. Shoqëria duhet të kryejë çdo aktivitet që përfshihet në objektin e saj, në lidhje dhe që e favorizon atë. Shoqëria duhet të respektojë të gjitha ligjet dhe rregulloret përkatëse. Ajo përfshin standartet më të mira etike.

KAPITALI I SHOQERISE

NENI 5

Kapitali i shoqërisë tregtare private "AGL Building Trade and Consulting" Sh.p.k. do te jete 6.000,00 EURO (gjashtëmije) dhe përbehet nga kuotat qe i përkasin anëtareve te shoqërisë, ku një kuotë ka vlerë nominale 3.000,00 euro (tremije), si me poshtë vijon:



1. **Z. Artur Shapka**, emri i babait Vasil Shapka, lindur ne Durrës me 28.09.1972 dhe banuese ne Lagja 17, Pallati 774, Durrës, me Pasaporte nr. BA8286436, Shtetas Shqiptar, madhore me zotësi te plote juridike për te vepruar, zotëron **1 kuote**, të barabarte me 50% te kapitalit themeltar te shoqerise me vlere monetare **3.000,00 euro**,

2. **Z. Giovanni Ferraro**, emri i babait Giuseppe Ferraro, lindur ne Pompei, Napoli (Itali) me 08.02.1978 dhe banues ne Rr. Annunziatella, nr.135, Boscotrecase (Napoli – Itali), cap. 80042. Pasaporte nr. YC0737033, Shtetas Italian, madhor me zotësi te plote juridike për te vepruar, zotëron **1 kuote**, të barabarte me 50% te kapitalit themeltar te shoqerise me vlere monetare **3.000,00 euro**,

Kapitali themeltar i shoqërisë mund te shtohet ose pakësohet dhe është tërësisht i likuidueshem dhe i nënshkrueshem.

NENI 6

Kapitali i shoqërisë përbehet nga kapitali themeltarr, nga pasuri te luajtshme ose te pa luajtshme dhe nga pasuri te tjera te dhëna ose qe do te jepen te cilat janë te domosdoshme për ushtrimin e aktivitetit te shoqërisë.

NENI 7

Kuotat e kapitalit derdhen nga ortakët e shoqërisë ne Banke, ne llogarinë bankare te shoqërisë dhe derdhja e kuotës regjistrohet ne librin e llogarisë se shoqërisë.

NENI 8


Fitimet e shoqërisë i takojnë ortakeve te saj. Asambleja sipas ligjit vendos për ndarjen ose riqarkullimin e tyre duke përcaktuar edhe modalitetet.

NENI 9

Shoqëria tregtare **"AGL Building Trade and Consulting" Sh.p.k.** është përdoruese dhe zotëruese e pasurisë se saj. Ajo mund te blejë dhe te shfrytëzoje te drejta te tjera, materiale ose jo-materiale, duke përfshire edhe te drejtën për shitjen e pasurisë se vet te akumuluar, tek te tjerët.

Ne Republikën e Shqipërisë, **"AGL Building Trade and Consulting" Sh.p.k.** gëzon te drejta sikundër çdo person tjetër juridik, shqiptar ose i huaj, sipas legjislacionit ne fuqi.

NENI 10



Shoqëria "AGL Building Trade and Consulting" Sh.p.k. vepron ne regjimin e pronës private dhe merr përsipër te drejtat e detyrimet vetëm brenda kufirit te kapitalit te saj. Ortaket e shoqërisë mbajne përgjegjësi te plote mbi veprimtarinë e saj, vetëm ne nivelin e kapitalit te investuar ne te.

MENYRA E FITIMIT DHE KALIMIT TE KUOTAVE

NENI 11

Bazuar në nenin 73 të ligjit nr.9901/2008 Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave. Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- shitblerjes;
- trashëgimisë;
- dhurimit;
- çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet jete ne forme te shkruar.. Ky Statut kushtëzonte kalimin e kuotave, duke përcaktuar:


Ortaku qe deshiron te shese Kuoten e tije ose nje pjese te saje duhet ti jape njoftim me shkrim shoqerise te pakten 3 muaj perpara duke i ofruar ortakut ose ortakeve te tjere mundesine te ushtrojne te drejten e parablerjes mbi kete kuote ose pjese te saje. Ne njoftim duhet te percaktohet vlefta e shitjes se kuotes ose pjeses se saje qe eshte objekt shitje.

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

NENI 12

Bëjnë pjese ne detyrat dhe kompetencat administratorit te vetëm te Shoqërisë, i paracaktuar ne Aktin e Themelimit, te gjitha ato qe janë parashikuar dhe rregulluar me ligj, si dhe te listuar ne këtë statut. Nder këto detyra përfshihen:

1. ndryshimi ne statut dhe ne aktin e themelimit;
2. miratimi i buxhetit vjetor, te veprimtarisë se administrimit, te inventarit, te bilancit te llogarisë vjetore;
3. emërimi e shkarkimi i administratoreve jo-ortake dhe përcaktimi i detyrave dhe kompetencave te tyre, duke përcaktuar se qofte për emërimin ashtu edhe për shkarkimin nuk do te jete e domosdoshme te jepet shprehimisht një shkak;



4. miratimin e kredive dhe te garancive;
5. miratimi i tarifave për shërbimet qe kryen shoqëria;
6. pranimet ne pune, pagat, largimet nga puna, masat disiplinore për vartësit, miratimin e kërkesave për largim nga puna;
7. përcaktimi i formës se vulës dhe te markës se shoqërisë;
8. zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit te shoqërisë;
9. mbikëqyrja e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, përfshire përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurisë se veprimtarisë se shoqërisë;
10. miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurisë se veprimtarisë se shoqërisë;
11. vendimin lidhur me krijimin apo mbylljen e filialeve, përfaqësimeve ose e agjencive te shoqërisë;
12. vendimin për riorganizimin dhe mbylljen e shoqërisë;
13. vendimin për nisjen e një mosmarrëveshje ligjore apo për zgjidhjen e një mosmarrëveshje ligjore ne te cilën është e përfshire shoqëria;
14. vendimin për emërimin dhe shkarkimin e likuidatorëve dhe te eksperteve kontabël te autorizuar apo te konsulentëve te tjerë, qofte persona fizike qofte juridike;
15. vendimin për ndarjen e kuotave dhe për anulimin tyre;
16. vendimin për miratimin dhe ndryshimin e rregullave te procedurës për mbledhjen e asamblesë;
17. vendimin për dhënien ose revokimin e prokurave te përfaqësimit te shoqërisë;
18. vendimin ne shitjet e kuotave te shoqërisë;
19. vendimin për çështje te tjera te parashikuara me ligj apo nga statuti;
20. marrjen e çdo vendimi tjetër qe nuk i është deleguar ndonjë organi tjetër.

NENI 13

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi te dërguar nga administratori drejt ortakeve te tjere me shkrese ose sipas zgjedhjes se administratorit nëpërmjet postes elektronike.



Njoftimi për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e duhet t'u dërgohet të gjithëve jo më vonë se 7 dite përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas modalitetit të lartpërmendur, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm në rast se të gjithë ortaket janë dakord, për të marrë këto vendime, pavarësisht nga mungesa e njoftimit për thirrje.

NENI 14

Vendimet e asamblesë së përgjithshme merren në formën e vendimeve me shkrim.

Procesverbali i vendimeve duhet t'i dorëzohet administratorit, i cili e regjistron në regjistrin e vendimeve, që do të ruhet në selinë ligjore të shoqërisë nën kujdesin e administratorit.

Vendimet e asamblesë së përgjithshme mund edhe të merren jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Në këtë rast do t'i nënshtrohen procedurave të parashikuara nga ligji shqiptar të njohjes së dokumenteve të huaja në Shqipëri.


NENI 15

Administratori i shoqërisë është **Z. Artur Shapka**, emri i babait Vasil Shapka, lindur në Durrës me 28.09.1972 dhe banuese në Lagja 17, Pallati 774, Durrës, me Pasaportë nr. BA8286436, Shtetas Shqiptar, madhore me zotësi të plote juridike për të vepruar, i cili ushtron të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë duke zbatuar politikën tregtare konform ligjit të Republikës së Shqipërisë.

Z. Artur Shapka, emri i babait Vasil Shapka, lindur në Durrës me 28.09.1972 dhe banuese në Lagja 17, Pallati 774, Durrës, me Pasaportë nr. BA8286436, Shtetas Shqiptar, madhore me zotësi të plote juridike për të vepruar, ngarkohet në detyrën e Administratorit të shoqërisë në fjale nga momenti i regjistrimit të saj në QKB për një periudhë 5 (pese) vjetecare me të drejte rimerimi.


Asambleja e përgjithshme mund të emëroje edhe me shumë se një administrator, të çfarëdo kombësie. Në rastin e emërimit të një apo me shumë administratorëve në fuqi, të gjithë administratorët do të jenë përgjegjës individualisht dhe në formë solidare në përmbushjen e funksioneve të dhëna nga ligji për administratorin.

NENI 16



Administratori kryen detyrat ne ketë statut dhe te gjitha ato detyra te parashikuara dhe te rregulluara me ligj. Nder këto përshihen detyrat e listuara me poshtë.

1. Te veproje dhe te nënshkruaje ne emër te shoqërisë.
2. Te hartoje rregulloren e brendshme te shoqërisë dhe një plan biznesi për vitin financiar.
3. Te marre vendime lidhur me kreditë qe do te merren dhe dhënien e garancive.
4. Te përpunoje raporte për ecurinë e aktivitetit te shoqërisë dhe te bilancit te mbylljes se aktivitetit financiar te vitit paraardhës, sipas asaj qe parashikohet ne ligj.
5. Te mbaje ne rregull regjistrin e vendimeve te asamblesë se përgjithshme.
6. Administratori (apo administratoret ne rast se do te emërohet ndonjë tjetër ne vijim) është përgjegjës kundrejt shoqërisë dhe te palëve te treta për shkeljet e ligjit apo te normave te statutit qe mund te ndodhin gjate ecurisë se aktivitetit, sipas legjislacionit shqiptar.
7. Te kryeje te gjitha aktivitetet e administrimit te aktivitetit tregtar te shoqërisë, duke aplikuar politikat tregtare.
8. Te përfaqësoje shoqërinë tregtare.
9. Te kujdeset për mbajtjen e dokumenteve dhe te librave kontabël te shoqërisë me korrektësi dhe saktësi.
10. Te kryeje regjistrimet dhe te dërgoj te dhënat e detyrueshme te shoqërisë, siç parashikohet ne ligjin për Qendrën Kombëtare te Regjistrimit.
11. Te kryeje detyra te tjera te përcaktuara ne ligj dhe ne statut.
12. Te raportoje përpara asamblesë se përgjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posaçme me rendësi te veçante për veprimtarinë e shoqërisë tregtare.
13. Ai ka te drejte te caktojë financier, likuidator e konsulentë për problemet e shoqërisë. Financieri nxjerr rregullisht indikatorët financiare te tre-mujore, 6-mujore dhe vjetore, për aktivitetin e kryer te shoqërisë.
14. Te mire-administroje shoqërinë.
15. Te lidhe marrëveshje me te treta ne kufijtë e objektit te aktivitetit te shoqërisë dhe te kompetencave te përcaktuara nga ortaket.



16. Te zbatoje rregulloren e brendshme te shoqërisë.
17. Te jete përgjegjës për demet e shkaktuara shoqërisë nga veprimet e tij.
18. Te shpërblehet për punën qe kryen sipas legjislacionit ne fuqi ne Republikën e Shqipërisë..
19. Te informohet dhe te beje propozime për çfarëdolloj gjeje qe e vlerëson si te rëndësishme për shoqërinë.
20. Te kryeje te gjitha veprimet bankare ne lidhje me llogarinë e shoqërisë.
21. Administratori ka te drejte dhe detyre te thërrasë asamblenë e përgjithshme, sipas dispozitave te përcaktuara ne nenet 12 dhe 13 te këtij statuti dhe te ligjit aty ku nuk parashikohet shprehimisht ne statut.

TE DREJTAT DHE DETYRIMET E SHOQERISE

NENI 17


Shoqëria ka te drejte:

1. te kryeje veprimtari ne baze te interesave qe ka ne përputhje me objektin e veprimtarisë;
2. te siguroje pasurinë e vete;
3. te marre kredi ne leke dhe ne valute nga Bankat vendase ose te huaja ne baze te rregullave ligjore;
4. te përfitoje nga favorete qe i njeh legjislacioni shqiptar lidhur me tatimet dhe te tjera;
5. te investoje kudo ne Shqipëri, me te ardhurat qe realizon gjate ushtrimit te aktivitetit te saj;
6. te punësoje punëtore, vendas ose te huaj;
7. te eksportoje lirisht valutën qe ka realizuar nga fitimet e saj.

NENI 18

Shoqëria ka për detyre:

1. te siguroje kapitalin e shoqërisë ne formën dhe kohen e duhur;
2. te japë garanci për shërbimet qe kryen shoqëria;
3. te siguroje punonjësit e saj;



4. te plotësoje detyrimet fiskale dhe sociale qe ka ndaj shtetit, si edhe detyrimet kontraktuale ndaj cilitdo;
5. te respektoje standardet si dhe te gjitha rregullat qe lidhen me veprimtarinë e saj.

MARRDHENJET EKONOMIKO-FINANCIARE TE SHOQERISE

NENI 19

E gjithë veprimtaria e shoqërisë për plotësimin e objektit te veprimtarisë se saj, pasqyrohet ne bilancin ekonomik te saj.

NENI 20

Ne selinë e shoqërisë mbahet dokumentacioni financiar, ne baze te cilit, brenda datës 31 Mars te çdo viti hartohet bilanci i vitit ushtrimor.

NENI 21

Viti financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor.

NENI 22

Shoqëria mban xhiro-llogarite ne Banke. Llogarite mbahen ne leke dhe pasqyrohen ne librat përkatëse.

NENI 23

Nga fitimet e realizuara gjate vitit financiar, shoqëria, pasi bën zbritjen e humbjeve te vitit te mëparshëm, le mënjanë 5% te fitimit, me te cilin krijohet fondi "Rezerve e domosdoshme", derisa ky fond te arrije masën 10% te kapitalit themeltar.

DISPOZITA TE VECANTA

NENI 24


Shoqëria ka vulën e vet dalluese dhe mund te ketë një marke te sajën.

SHNDERRIMI DHE PRISHJA E SHOQERISE

NENI 25

Shndërrimi i shoqërisë "AGL Building Trade and Consulting" Sh.p.k.. ne shoqëri te formave te tjera, mund te behet me vendim te ortakeve themelues sipas modaliteteve te parashikuara me ligj.

NENI 26



Shpërbërja e shoqërisë, mund të vijë për shkaqet e parashikuara në nenin 99 të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008:

- humbja e kapitalit të shoqërisë,
- pamundësi veprimi,
- me vendim të ortakëve të saj.

Në këto raste, ortakët e shoqërisë vendosin mbi mënyrën e likuidimit dhe caktojnë një ose më shumë likuidatorë duke u përcaktuar edhe detyrat. Administratori dhe likuidatori janë përgjegjës për ruajtjen e pasurisë së shoqërisë deri sa ajo t'u dorëzohet personave përkatës fizike e juridike, duke likuiduar në radhë të parë detyrimet që ka shoqëria ndaj personave të tjerë.

Në rast se fondet e disponueshëm, rezultojnë të pa mjaftueshëm, për shlyerjen e detyrimeve të shoqërisë, likuidatori mund t'i kërkojë ortakëve themelues të shoqërisë që të derdhin tërësisht kuotat që i takojnë.

DISPOZITA TË PËRGJITHESHME

NENI 27

Për sa nuk është parashikuar shprehimisht në këtë statut, do të referohet legjislacionit shqiptar si edhe ndryshimeve të mëvonshme që do të kryen nga asambleja e përgjithshme e ortakëve sipas ligjit, në formën e aktit publik.


NENI 28

Ky statut përpilohet në 3 (tre) ekzemplare origjinale, që konsistojnë në 10 (dhjetë) faqe, ku një qëndron pranë selisë së shoqërisë dhe dy të tjera i dorëzohen ortakëve të shoqërisë.


ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË "AGL Building Trade and Consulting" Sh.p.k

1. Z. Artur Shapka

ARTUR SHAPKA



2. Z. Giovanni Ferraro



FERRARO GIOVANNI